



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:092610

Datë: 07.06.2024

Numri i dokumentit: 05793643

KPPP.nr.695/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komuna e Shtimes –Inspektorati Sanitar, kundër debitorit N.T.P “Beli Comerc” me seli në Mitrovicë, dhe me pronar F.B., vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 126/20 të datës 15.09.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Hilmi Mifaraj me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datë 07.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit N.T.P “Beli Comerc” me pronar F.B. ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 126/20 i datës 15.09.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Hilmi Mifaraj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Shtimes –Inspektorati Sanitar me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit Aktvendim nr. 08/98 të datës 15.05.2020 ka caktuar zbatimin e përmbartimit përmes urdhrit përmbartimor P.nr. 126/20 të datës 15.09.2020 ndaj debitorit N.T.P “Beli Comerc” me pronar F.B., të cilin e ka detyruar që në emër të pagesës së detyrimeve doganore sipas aktvendimit të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit prej 500.00 EUR, dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka deklaruar se aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është i kundërligjshëm pasi që në të njëjtin nuk janë shënuar me saktësi të dhënat e kërkuara ligjore për kreditorin e po ashtu, të dhëna e shënuara në propozimin për përmbartim për

debitorin janë të pasakta, pasi që drejtor i debitorit është shënuar F.K. dhe jo F.B.. Tutje ka shtuar se dokumenti përmbartimor nuk është i pajisur me vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, andaj si i tillë është i papërshtatshëm për përmbartim. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të refuzohet propozimi për përmbartim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me konkluzionin PPP.nr. 663/20 të datës 30.12.2020 ka obliguar kreditorin që në afat prej tre (3) ditësh nga pranimi i të njëjtit, të dorëzoj vendimin nr. 08/98 të datës 15.05.2020 në original ose kopje të vërtetuar dhe të pajisur me vule të ekzekutueshmërisë. Ndërsa, me aktvendimin PPP.nr. 663/20 të datës 02.02.2021, gjykata e lartcekur, e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbartim të këtu kreditorit Komuna e Shtimes ndaj debitorit N.T.P “Blerim Comerc” me arsyetimin se kreditori nuk ka vepruar sipas konkluzionit për plotësimin e përmbartimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.Dh.Sh.II.nr. 436/22 të datës 17.04.2024, ka aprovuar ankesën e kreditorit Komuna e Shtimes dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje pranë Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj gjykate. Në arsyetimin e saj ka theksuar se Gjykata Themelore në Mitrovicë, ka vepruar gabimisht kur propozimin për përmbartim të kreditorit e ka konsideruar të tërhequr, kjo pasi që kreditori, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se ka vepruar në përputhje me konkluzionin PPP.nr. 663/20 të datës 30.12.2020 dhe atë brenda afatit ligjor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna përmes aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr. 436/22 të datës 17.04.2024, shqyrtoi dhe vlerësoi provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht aktvendimi nr. 08/98 i datës 15.05.2020 në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti,

konform nenit 22 par. 1, nën-par. 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, dhe i cili vendim i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje vlerëson se aktvendimi nr. 08/98 të datës 15.05.2020, i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri*”, ngase i njëjti i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, ndërsa me parashtrësën e përpiluar nga kreditori me datë 08.08.2020 dhe të dorëzuar për gjykatën me datë 14.01.2021, është konfirmuar se aktvendimi nr. 08/98 është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 695/24, datë 07.06.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.